



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 2730/4 prot.

Elbasan, me 27.11.2025

VENDIM

Nr. 64 datë 27.11.2025

Për

**hapjen e programit të përbashkët të studimit të ciklit të dytë Master i shkencave në
"Shëndet Mendor" në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani"**

Bazuar në Ligjin nr. 80/2015 datë 21.05.2007 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë", neni 3, pika 2, shkronja b, neni 35, pika 1, neni 38 pika 1, germa "dh", neni 49, pika 1, në Udhëzimin e MASR nr.1, datë 14.01.2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen riorganizimin dhe mbylljen e IAL, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen dhe bashkimin e IAL", Kreu IV, germa A, i ndryshuar, si dhe në Udhëzimin nr.10, datë 30.03.2020 të Ministrisë të Arsimit dhe Sportit "Për përcaktimin e elementëve përbërës, formën e diplomës ose certifikatës të lëshuar nga IAL dhe procedurës së regjistrimit të tyre në regjistrin shtetëror të diplomave dhe certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor", i ndryshuar, Vendimit të Senatit Akademik nr. 75 datë 27.11.2025 "Për hapjen e programit të përbashkët të studimit të ciklit të dytë Master i shkencave në "Shëndet Mendor", Bordi i Administrimit,

V E N D O S I:

1. Të miratojë hapjen e programit të përbashkët të studimit të ciklit të dytë Master i shkencave në "Shëndet Mendor", në Departamentin e Specialiteteve Teknike Mjekësore në Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike në bashkërendim me Fakultetin e Shëndetit në Universitetin "Ismael Qemali" Vlorë.
2. Të miratojë listën e personelit akademik për realizimin e programit të përbashkët të studimit të ciklit të dytë Master i shkencave në "Shëndet Mendor", sipas shtojcës I që i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
3. Ky vendim i përcillet Rektorit, Administratorit të Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" dhe Fakultetit të shkencave mjekësore teknike të UE-së
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R I
Dr. Ardian BURMISHI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”
BORDI I ADMINISTRIMIT

Shtojca 1

Lista e personelit akademik për realizimin e programit të përbashkët të studimit të ciklit të dytë
Master Shkencor në “Shëndet Mendor”

1. Prof.Dr. Skënder Topi – Metodologjia e kërkimit shkencor në kujdesin shëndetësor.
2. Prof.as. dr Gazment Koduzi – Lidership, planifikim dhe menaxhim në kujdesin shëndetësor ndaj shëndetit mendor.
3. Prof.as.dr. Brunilda Elezi – Bazat e kujdesit dhe praktikës në shëndetin mendor. Parime dhe koncepte të përgjithshme.
4. Prof.as.dr. Gjergji Koja – Politikat shëndetësore për ndërhyrje efektive në shëndetin mendor.
5. Prof.as.dr. Elona Gaxhja – Etika, vlerat profesionale dhe komunikimi terapeutik në kujdesin ndaj shëndetit mendor.
6. Dr. Mitilda Gugu – Menaxhimi medikamentoz dhe aderenca ndaj terapisë në shëndetin mendor.

KRYETARI
Dr. Ardian DËRMISHI

